



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE

N J O F T I M

Për rikthimin në shqyrtim të aplikimeve të Skemës Kombëtare të Mbështetjes Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, viti 2026, të cilat janë përjashtuar nga përfitimi

Bazuar në Udhëzimin nr. 8, datë 14.05.2026, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026” si dhe Vendimin nr. 65, datë 03.09.2026 “Për shfuqizimin e përjashtimeve”:

Njofton se gjatë një rikontrolli administrativ të aplikimeve, u konstatua se lista e aplikantëve të përjashtuar për një afat 3 vjeçar (sipas listës bashkangjitur) është kryer jo në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 28.03.2025, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për masat mbështetëse për vitin 2025”,

Për këtë arsye, AZHBR vendosi shfuqizimin e listave të aplikantëve të përjashtuar nga e drejta e përfitimit për një periudhë 3-vjeçare dhe rikthimin e aplikimeve për vijimin e procedurës së shqyrtimit administrativ.

Për aplikimet që do rikthehen, shqyrtimi administrativ dhe llogaritja e afateve për dorëzimin e dokumentacionit shtesë, do të fillojë duke u llogaritur nga dita e nesërme e këtij njoftimi.

Aplikimet që do rishqyrtohen janë të publikuara në faqen zyrtare azhbr.gov.al.